



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. DPKI
Nr. Prot. 06-02/3197/22
Br. Prot. 06-02/3197/22
Prot No. 06-02/3197/22
Nr. i foli. 03
Data 04-08-2022
Broj stranica 03
Datum 04-08-2022
Nr. pages

REPUBLIC OF KOSOVO



Republika Kosova-Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, nenit 11 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, nenit 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit, me datë 01.08.2022, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti AKK-DPKI-06-2402/22, për zyrtarin e lartë z. Gzim Kllokoqi, Zyrtar Kryesor Financiar në NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A. në Gjilan, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit;
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë publik z. Gzim Kllokoqi, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në vijim: LPKI).

Ky rast ka filluar të trajtohet pasi që nga formulari i deklarimit të pasurisë së zyrtarit të lartë është identifikuar se z. Gzim Kllokoqi, krahas ushtrimit të funksionit publik në NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A. në Gjilan, është konsulent financiar në NPL "Tregu" SH.A. në Gjilan dhe në një OJQ, si dhe i njëjti ofron shërbime të kontabilitetit për disa subjekte (biznese) private.

Agjencia kundër Korrupsionit (në vijim: Agjencia), me shkresën zyrtare DPKI-06-02/2532/22, e ka njoftuar zyrtarin e lartë lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Pas kësaj, është organizuar dhe mbajtur një takim me zyrtarin e lartë në zyrat e Agjencisë, me ç'rast i njëjti është njoftuar me faktet që posedon Agjencia sa i përket pretendimit për konflikt të interesit lidhur me këtë rast.

Agjencia ka njoftuar zyrtarin në fjalë lidhur me kufizimet e përcaktuara me nenin 12 [Kufizimi i zyrtarit të lartë në ushtrimin e veprimtarive të tjera krahas ushtrimit të funksionit publik], të LPKIsë, me të cilin është përcaktuar se:

- “1. Zyrtari i lartë nuk mund të ushtrojë veprimtari profesionale të avokatisë, noterisë, përmbauesit privat, administratorit të falimentimit, ekspertit të licencuar, konsulentit ose agjentit të personave juridikë si dhe nuk mund të jetë i punësuar, me kohë të plotë, në një detyrë tjetër.*
- 2. Në kuptim të këtij neni, veprimtari profesionale nënkuptojnë veprimtarinë për të cilat kërkohet licencim sipas ligjit në fuqi.”*

Në takimin e mbajtur z. Gzim Kllokoqi ka sqaruar secilin angazhim që ka dhe është shprehë i gatshëm të veproj konform kërkesave të Agjencisë, për shmangien e çfarëdo situatë të mundshme të konfliktit të interesit. Ndërsa përmes komunikimeve e korrespondencave elektronike ka dërguar në Agjenci dëshmitë për secilin angazhim që ka dhe për veprimet që ka ndërmarrë (DPKI-06-02/2532-1/22 dhe DPKI-06-02/2532-2/22).

Sa i përket faktit se z. Gzim Kllokoqi, krahas ushtrimit të funksionit publik në NPL “Stacioni i Autobusëve” SH.A. në Gjilan, është konsulent financiar në NPL “Tregu” SH.A. në Gjilan dhe në një OJQ, i njëjti ka deklaruar se kontrata me OJQ-në është shkëputur në muajin nëntor 2021 pasi që ka përfunduar projekti, si dhe ka sjellë dëshmi me të cilat konfirmohet se ka dorëzuar dhe protokolluar pranë NPL “Tregu” SH.A. në Gjilan, kërkesën për ndërprerjen e kontratës për ofrimin e shërbimeve si konsulent financiar në këtë ndërmarrje.

Ndërsa, sa i përket faktit se z. Gzim Kllokoqi ofron shërbime të kontabilitetit për disa subjekte (biznese) private, i njëjti ka sjellë dëshmi (kontrata dhe letër-angazhime) nga të cilat vërtetohet se zyrtari në fjalë ofron për këto biznese vetëm shërbime të kontabilitetit.

Andaj, duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar sipas dokumentacionit në dispozicion, Agjencia konstatoi se ofrimi i shërbimeve të kontabilitetit për subjekte (biznese) private nga z. Gzim Kllokoqi, Zyrtarit Kryesor Financiar në NPL “Stacioni i Autobusëve” SH.A. në Gjilan, nuk është në kundërshtim me dispozitat e nenit 12 të LPKI-së.

Kjo për faktin se, paragrafi 1 i nenit 12 të LPKI-së përcakton pamundësinë e zyrtarit të lartë publik që të ushtrojë veprimtarinë profesionale të avokatisë, noterisë, përmbauesit privat, administratorit të falimentimit, ekspertit të licencuar, konsulentit ose agjentit të personave juridikë, si dhe pamundësinë e zyrtarit të lartë publik që të jetë i punësuar në një detyrë tjetër me kohë të plotë. Ndërsa, paragrafi 2 i nenit në fjalë, përkufizon se ‘veprimtari profesionale’, në kuptim të nenit 12 të LPKI-së, nënkuptojnë ‘veprimtarinë’ për të cilat ‘kërkohet licencim’ sipas ligjit në fuqi.

Në këtë kontekst, sipas Ligjit Nr. 05/L-066 për profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës, Ligji Nr. 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim dhe akteve nënligjore në fuqi, për ofrimin e shërbimeve të kontabilitetit nuk kërkohet licencim (sikurse kërkohet p.sh. për auditor). Rrjedhimisht nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

Megjithatë, z. Gzim Kllokoqi gjatë ushtrimit të funksionit publik, në rast se paraqitet ndonjë situatë e mundshme e konfliktit “rast për rast” të interesit, në mënyrë që të shmangen këto situata është i obliguar ta deklaroj dhe të tërhiqet nga vendimmarrja në rastin e caktuar, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 17 të LPKI, si në vijim:

1. Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje.

2. Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtari, kur kjo kërkohet nga udhëheqësi ose nga institucioni udhëheqës apo mbikëqyrës. Deklarimi, si rregull, duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi duhet të kërkohet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur por jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga data e kërkesës ose e konstatimit të konfliktit të interesit.


3. Vetëdeklarimi ose deklarimi me kërkesë si rregull bëhet me shkrim, kur zyrtari përfshihet në një vendimmarrje për ndonjë çështje të caktuar.[...]

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në pikën I të dispozitivit të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11, të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihapë rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)


Yll Buleshkaj
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

